



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1, nenit 5 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.06.2022, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-1736-A/22, për zyrtarin e lartë publik z. Altin Sahiti, zv. Kryesues i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të mundshëm interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Altin Sahiti, zv. Kryesues i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia kundër Korrupsionit sipas raportimit (nga jashtë) e ka hapur rastin për situatë të mundshme të konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Sahiti duke qenë zyrtar i lartë publik, njëkohësisht mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat, situatë e cila bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Për t'i vërtetuar pretendimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare, është konstatuar se z. Sahiti e mbante funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat, "Novaza Tech" L.L.C.



Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit përmes shkresë (AKK-DPKI-06-02/1994/22) e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

Pas dërgimit të kësaj shkrese, Agjencia kundër Korrupsionit ka kontaktuar me z. Sahiti dhe e ka njoftuar atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”,

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarre veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-021994-1/22) me dokumentet përcjellëse, në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat.

Me veprimet e ndërmarra nga z. Sahiti, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit